



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 103 Prot

Tiranë, më 31.03 2014

VENDIM Nr. 295, dt. 31.03.2014

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 31.03.2014, mbasi shqyrtoi kërkesën për miratimin e lejes arkeologjike për Projektin: "**Rehabilitimi dhe rivitalizimi i shëtitores Republika dhe Sheshit Teodor Muzaka**", Parku perëndimor dhe Parku Lindor, Berat, paraqitur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF),

VENDOSI:

- I. Të miratojë vazhdimin e punimeve në Lotin I të Projektit: "**Rehabilitimi dhe rivitalizimi i shëtitores Republika dhe Sheshit Teodor Muzaka**", Parku perëndimor dhe Parku Lindor, Berat, paraqitur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.
- II. Të realizohen panele informues për gjurmët e kolektorëve të zbuluar gjatë zbatimit të Lotit I të projektit.
- III. Përpara fillimit të zbatimit të loteve të tjera të projektit të nënshkruhet kontrata dypalëshe midis Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim ku të përcaktohen në mënyrë të detajuar detyrimet e palëve.
- IV. Të kryhen sondazhe arkeologjike për të përcaktuar vazhdimësinë e gjurmëve të kolektorit të zbuluar.
- V. Gjatë zbatimit të punime të realizohet mbikëqyrja arkeologjike periodike e punimeve nga specialistë arkeologë të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Berat dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI I KKA
ARTAN PUTO



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, Nr. 76. Tiranë, Shqipëri,

Tel/Fax: 04 2272171

www.asha.gov.al